



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 25 korrik 2022
Nr.ref.: RK 2026/22

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI19/22

Parashtrues

Lutfi Santir

**Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës
Supreme të Kosovës, Rev. nr. 162/2021, të 8 nëntorit 2021**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

në përbërje:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendës kryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është Lutfi Santir nga Prizreni (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 162/2021, të 8 nëntorit 2021.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, me të cilin pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesioneve] dhe nenin 54 [Mbrotjtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta), si dhe me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji) dhe rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 8 shkurt 2022, Gjykata e pranoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës.
6. Më 14 shkurt 2022, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.
7. Më 22 shkurt 2022, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bajram Ljatifi gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Safet Hoxha (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi (anëtarë).
8. Më 22 qershor 2022, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues njëzëri/ i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Nga shkresat e lëndës rezulton se parashtruesi i kërkesës, si pronar i kompanisë AT "Expres-Tur" me seli në Prizren, për më shumë se 15 vjet ushtroi veprimtarinë e transportit publik të udhëtarëve brenda apo jashtë vendit. Gjatë vitit 2002, Ministria e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit (në tekstin e mëtejshëm: Ministria) shpalli konkursin për ndarje të lejeve për ushtrimin e qarkullimit me autobusë. Parashtruesi paraqiti kërkesën për marrjen e lejes për ushtrimin e qarkullimit me autobusë në relacionin Prizren-Prishtinë dhe anasjelltas, me kohën e nisjes në ora 16:30. Mirëpo, nga shkresat e lëndës rezulton se ai nuk e ka marrë atë leje, sepse, sipas pretendimeve të tij,

“zyrtari i Ministrisë në mënyrë të kundërligjshme e ka hequr firmën e tij nga orari zyrtar i vozitjes”.

10. Prandaj, më 29 nëntor 2003, parashtruesi i kërkesës paraqiti pranë Ministrisë kompetente *“Vërejtjen para padisë”* ku theksoi se, *“me sa ka dëgjuar ai e ka marrë orarin e udhëtimit për linjën Prizren-Prishtinë dhe anasjelltas, me nisje nga Prizreni në ora 16.30, por se ky orar i udhëtimeve më pas është ndryshuar arbitrarisht nga zyrtari i Ministrisë, dhe me këtë ai është vendosur në një pozitë diskriminuese dhe i është shkelur e drejta e punës”*. Rrjedhimisht, ai kërkoi nga Ministria kompetente informata për vendimin lidhur me kërkesën e tij, meqenëse i njëjti nuk i është dorëzuar.
11. Më 10 nëntor 2004, Ministria e dërgoi Memorandumin nr. 1/2004 ku e informon parashtruesin e kërkesës se *“Komisioni për harmonizimin e vijave dhe orareve konstatoi se operatori “Expres-Tur” nga Prizreni nuk ka aplikuar me kohë në afatin e paraparë për aplikim, për vërtetimin e rendit të udhëtimit, andaj në bazë të këtij fakti kërkesa konsiderohet e paafatshme [...]”*.
12. Më 25 nëntor 2004, parashtruesi i kërkesës paraqiti një ankesë pranë Ministrisë kundër Memorandumit nr. 1/2004 të 10 nëntorit 2004.
13. Më 21 dhjetor 2004, Ministria e lëshoi një Memorandum të ri si përgjigje ndaj ankesës së parashtruesit të kërkesës, në të cilin theksoi se: *“Komisioni i MTPT-së konstatoi se vendimi për refuzimin e kërkesës së operatorit A.T. “Expres-Tur” nga Prizreni, i cili është atakuar me anë të kësaj ankese është i drejtë. Në bazë të vendimit me të cilin është refuzuar kërkesa në fjalë, ku është konstatuar se operatori A.T. “Expres-Tur” nuk ka aplikuar me kohë në afatin e paraparë për aplikim, për vërtetimin e rendit të udhëtimit dhe në bazë të këtij fakti kërkesa është konsideruar e pasafatshme, gjithashtu është konstatuar se kjo kompani nuk ka pasur asnjëherë më parë rend të udhëtimit të vërtetuar nga Ministria e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit e Kosovës”*.
14. Më 2 korrik 2007, parashtruesi i kërkesës i dërgoi një kërkesë Ministrisë, duke kërkuar që për shkak të mosdhënies së lejes për ushtrimin e qarkullimit me autobusë në linjën Prizren-Prishtinë dhe anasjelltas, t’i kompensohet dëmi, duke përfshirë edhe fitimin e humbur, në shumë të përgjithshme prej 239,853.91 euro.
15. Më 31 dhjetor 2007, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesëpadi në Gjykatën Komunale në Prishtinë kundër Ministrisë, duke kërkuar që t’i kompensohet dëmi material në shumë prej 220,500.00 euro, si dhe interesi në shumë prej 9,508.32 euro, i cili është krijuar me veprimin kundërligjor të zyrtarit të Ministrisë i cili e hoqi arbitrarisht kompaninë e tij *“Expres-Tur”* nga lista e orarit të udhëtimit në linjën Prizren-Prishtinë dhe anasjelltas.
16. Më 14 janar 2010, Gjykata Komunale nxori Aktvendimin P. nr. 3133/07, përmes të cilit u deklarua jokompetente në procedurën në fjalë, duke theksuar

se “kontesti në fjalë ndërmjet palëve kontestimore është një konflikt administrativ për të cilin mund të iniciohet procedura administrative”.

17. Parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Qarkut kundër Aktvendimit të Gjykatës Komunale P. nr. 3133/07.
18. Më 17 dhjetor 2013, Gjykata e Apelit nxori Aktvendimin CA. nr. 1647/2012, me të cilin e anuloi Aktvendimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë C. nr. 3133/07 të 14 janarit 2010 dhe e ktheu çështjen në Gjykatën Themelore në rishqyrtim, duke theksuar se: “Me nenin 16 të Ligjit për Gjykatat Nr. 03/L-199 (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr. 79/2010) është përcaktuar: “Departamenti i Përgjithshëm i Gjykatës Themelore gjykon në shkallë të parë gjitha çështjet, përveç nëse kjo është në kompetencën e një Departamenti tjetër të Gjykatës Themelore”. Nga interpretimi i dispozitave të lart cituara, kolegji vlerëson se çështja juridike e iniciuar nga pala paditëse është në kompetencën e Gjykatës Themelore në Prishtinë–Departamenti i Përgjithshëm Civil”.
19. Më 12 janar 2015, Gjykata Themelore, në rigjykim, nxori Aktgjykimin C. nr. 3426/13, me të cilin e refuzoi si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës për kompensim.
20. Në arsyetimin e Aktgjykimit C. nr. 3426/13, Gjykata Themelore theksoi:

“Gjykata në bazë të vërtetimit të kësaj gjendje faktike, vlerëson se kërkesëpadia e paditësit për shpërblimin e dëmit material që ju është shkaktuar si pasojë e pamundësisë së ushtrimit të veprimtarisë së tij të transportit të udhëtarëve në linjën Prizren-Prishtinë, në ora 16:30, për periudhën prej dt. 20.08.2002 deri më dt. 20.12.2014, në shumën 220.500,00€ nuk ka bazë juridike, kjo sepse paditësi nuk ka iniciuar konfliktin administrativ pranë Gjykatës Supreme të Kosovës, si kompetente në pikëpamje lëndore për të bërë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimeve të paditurit – Ministrisë së Transportit dhe Postelekomunikacionit ku është refuzuar aplikacioni – kërkesa e paditësit e dt. 04.09.2004. Prandaj në rastin konkret paditësit i mungon baza juridike për të kërkuar shpërblimin e dëmit, pavarësisht nga fakti se dëmi është shkaktuar, por ligjshmëria e vendimeve të paditurit nuk është kundërshtuar nga paditësi i cili ka pasur mundësi që me padi të inicion konfliktin administrativ, në afatin ligjor prej 30 ditëve nga momenti kur e ka pranuar memorandumën e dt. 21.12.2004.

Gjykata e shkallës së parë vlerëson se për t’ju njohur e drejta e shpërblimit të dëmit material, paditësi nuk mjafton me prova vetëm të vërtetoi faktin e ekzistimit të dëmit material i cili fakt është vërtetuar, por duhet me prova të vërtetoi edhe faktin e ekzistimit të përgjegjësisë lidhur me dëmin e shkaktuar, ndërsa në rastin konkret paditësi sipas barrës së provës, në kuptim të dispozitës së nenit 322.2 të LPK-së nuk e ka vërtetuar ekzistimin e faktit të përgjegjësisë së të paditurit – përkatësisht të punësuarve të saj për dëmin e shkaktuar (lidhja kauzale e veprimit apo mos veprimit të Ministrisë/të punësuarve me pasojën), që është fakt i rëndësishëm në

realizimin e drejtës subjektive për shpërblim dëmi dhe për këtë arsye gjykata e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit.

Gjykata e ka refuzuar edhe kërkesën për kamatë pasi kjo kërkesë është e varshme nga kërkesa kryesore e cila u refuzua më lartë”.

21. Parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore C. nr. 3426/13, duke pretenduar shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.
22. Më 3 shtator 2019, Gjykata e Apelit nxori Aktgjykimin Ac. nr. 2074/2015, me të cilin e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi në tërësi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore.
23. Në arsyetimin e Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit thuhet: “[...] Lidhur me pretendimet ankimore për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe zbatim të gabuar të drejtës materiale nuk qëndrojnë, pasi që nga shkresat e lëndës konstatohet se të gjitha faktet e çështjes janë provuar me prova përkatëse... [...].

[...] gjykata e shkallës së parë drejtë ka vërtetuar se paditësit i mungon baza juridike për të kërkuar shpërblimin e dëmit, pavarësisht nga fakti se dëmi është shkaktuar, por që nuk është kundërshtuar ligjshmëria e vendimeve të të paditurës nga ana e paditësit, i cili është dashur që me padi të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Supreme të Kosovës, si gjykatë e kompetencës lëndore për shqyrtimin e ligjshmërisë së vendimeve të organeve administrative.

[...] për të ekzistuar e drejta për shpërblimin e dëmit duhet që fillimisht të ekzistojë përgjegjësia lidhur me dëmin e shkaktuar, e nuk mjafton që vetëm të vërtetohet fakti i ekzistimit të dëmit material. Këtë përfundim të gjykatës së shkallës së parë e pranon edhe kjo gjykatë duke vlerësuar se në rastin konkret drejtë është vepruar dhe vërtetuar gjendja faktike”.

24. Parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme, kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit Ac. nr. 2074/2015 si dhe Aktgjykimit të Gjykatës Themelore C. nr. 3426/13, duke deklaruar si bazë kryesore faktin se “aktgjykimet e Gjykatës Themelore dhe Gjykatës së Apelit janë marrë me zbatimin e gabuar të drejtës materiale, sepse në këto aktgjykime nuk janë zbatuar dispozitat e Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve për shpërblimin e dëmit”.
25. Më 8 nëntor 2021, Gjykata Supreme nxori Aktgjykimin Rev. nr. 162/2021, me të cilin e refuzoi si të pabazuar kërkesën për revizion të parashtruesit të kërkesës, duke theksuar se:

“Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, bazuar në nenin 189 par. 1 të Ligjit për Detyrimet, “i dëmtuari ka të drejtë në shpërblimin e dëmit të thjeshtë dhe fitimit të humbur”. Me par. 3 të këtij neni është

përcaktuar se “gjykata gjatë vlerësimit të lartësisë së fitimit të humbur merr parasysh fitimin që ka mundur të pritët sipas rrjedhjes së rregullt të sendeve apo rrethanave të veçanta, realizimi i të cilit është penguar me veprimet ose mosveprimet e dëmtuesit”. Sipas dispozitës në fjalë, të dëmtuarit duhet t’i pranohet shpërblimi i dëmit në emër të fitimit të humbur, nëse i plotëson kushtet e caktuara dhe këto janë: që dëmi në formën e fitimit të humbur të jetë evident dhe të ekzistojnë elemente në bazë të të cilave mund të caktohet fitimi i humbur dhe që ky të mos jetë në kundërshtim me dispozitat në fuqi dhe me doket e mira afariste.

Nëse i referohemi kësaj dispozite ligjore. Gjykata e instancës ma të ultë, me të drejtë ka vërtetuar se nuk ka bazë juridike për shpërblimin e dëmit në emër të fitimit të humbur, dhe se nuk është vërtetuar se me veprimet e të paditurës, është shkaktuar dëmi material.

Kushtet e përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar nga punëtori ose nga organi shtetëror janë se dëmi duhet të shkaktohet duke kryer punë ose veprimtari të organeve shtetërore dhe se dëmi duhet të jetë i shkaktuar me veprim të paligjshëm ose në punë të parregullt. Këto kushte duhet të plotësohen në mënyrë kumulative duke respektuar specifikat e dëmit të shkaktuar të organit shtetëror. Në kompetencat e Ministrisë së Infrastrukturës ka qenë dhënia e lejeve për linja për personat juridike që ushtrojnë veprimtarinë e transportit të udhëtarëve, paditësi ka aplikuar për linjën Prishtinë-Prizren dhe anasjelltas, për në ora 16.30 dhe se kërkesa e të njëjtit është refuzuar nga e paditura, nga arsyeja se paditësi aplikimin e ka bërë pas afatit ligjor, prandaj pretendimet e paditësit në revizion se e paditura në mënyrë arbitrare ka marrë lejen e paditësit për linjën në fjalë nuk qëndrojnë”.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

26. Parashtruesi i kërkesës pretendon se aktgjykimet e gjykatave të rregullta shkelin të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesioneve] dhe nenin 54 [Mbrotja Gjyqësore e të Drejtave], si dhe me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.

Pretendimet për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës

27. Më konkretisht, parashtruesi i kërkesës pretendon se i janë shkelur të drejtat për gjykim të drejtë sipas nenit 31 të Kushtetutës, “[...] sepse gjykatat në rastin tim nuk e kanë analizuar thelbin e kërkesës për dëmshpërblim – kanë konstatuar sipërfaqësisht se nuk kam të drejtë në dëmshpërblim sepse unë nuk kam iniciuar konfliktin administrativ”. Në mbështetje të këtyre pretendimeve, parashtruesi i kërkesës shton se, “Gjykatat në rastin tim me qëllim kanë zhagatur procedurën gjyqësore, e cila ka qenë e iniciuar në vitin 2007 dhe është kryer në vitin 2021. Nga ana tjetër, Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës ka përzier termat [...] dhe faktet dhe ato janë në kundërshtim me provat që janë në shkresat e lëndës, prandaj, mendoj se me një konstatim të tillë cenohet e drejta ime për një gjykim të drejtë nga neni 31 i

Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nga Neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”.

Pretendimet për shkelje të nenit 49 të Kushtetutës

28. Parashtruesi pretendon se i janë shkelur edhe të drejtat kushtetuese të garantuara me nenin 49 të Kushtetutës, për shkak se emri i kompanisë së tij është hequr nga orari i udhëtimeve në mënyrë arbitrare nga zyrtari i Ministrisë dhe jo sipas ligjit. Parashtruesi veçanërisht thekson faktin se “firma “Expres-Tur” është e vetmja firmë në pronësi të një pjesëtari të pakicës në Kosovë”.

Pretendimet për shkelje të nenit 54 të Kushtetutës

29. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës konsideron se i është shkelur edhe e drejta për mbrojtje gjyqësore të të drejtave nga neni 54 i Kushtetutës për shkak se: “e paditura në vendimet e saj (në Memorandumin e dt. 10.11.2004 dhe në Memorandumin e dt. 21.12.2004) fare nuk ka dhënë udhëzimin për mjetin juridik për mbrojtje gjyqësore”. Gjithashtu, për arsye se Gjykata Komunale ka konstatuar se konflikti ndërmjet palëve është konflikt administrativ. “Edhe pse ka konstatuar kështu, Gjykata Komunale në Prishtinë nuk ka dërguar shkresat e lëndës gjykatës kompetente për konfliktet administrative, duke shkelur kështu të drejtën time për mbrojtje gjyqësore”.
30. Parashtruesi i kërkesës në fund kërkon nga Gjykata, “që të konstatohet shkelja e neneve të lartpërmendura të Kushtetutës [...] dhe nenit 6 të [KEDNJ-së], si dhe të anulohen vendimet e lartpërmendura si vendimet antikushtetuese”.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

“1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.

3. Gjykimi është publik, me përjashtim të rasteve kur gjykata, në rrethana të veçanta, konsideron se, në të mirë të drejtësisë, është i domosdoshëm përjashtimi i publikut, ose i përfaqësuesve të medieive, sepse prania e tyre do të përbënte rrezik për rendin publik ose sigurinë kombëtare, interesat e të miturve, ose për mbrojtjen e jetës private të palëve në proces, në mënyrën e përcaktuar me ligj.

4. Çdokush i akuzuar për vepër penale ka të drejtë t'u bëjë pyetje dëshmitarëve dhe të kërkojë paraqitjen e detyrueshme të dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet.

5. Çdokush i akuzuar për vepër penale, prezumohet të jetë i pafajshëm derisa të mos dëshmohet fajësia e tij/saj, në pajtim me ligjin.

6. Ndihma juridike falas do t'u mundësohet atyre që nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare, nëse një ndihmë e tillë është e domosdoshme për të siguruar qasjen efektive në drejtësi.

7. Procedurat gjyqësore që përfshijnë të miturit rregullohen me ligj, duke respektuar rregullat dhe procedurat e veçanta për të miturit”.

Neni 49

[E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit]

“1. E drejta e punës garantohet.

2. Secili person është i lirë të zgjedhë profesionin dhe vendin e punës”.

Neni 54

[Mbrotja Gjyqësore e të Drejtave]

“Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur”.

KONVENTA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Neni 6

(E drejta për një proces të rregullt)

„1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë [...] e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. [...]“.

DISPOZITAT LIGJORE

LIGJI Nr. 03/L- 202 për konfliktet administrative

Neni 9

“Gjykata në konfliktin administrativ vendos për ligjshmërinë e akteve përfundimtare administrative, me të cilat organet e administratës, në ushtrimin e autorizimeve publike, vendosin për të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të personave fizikë dhe juridikë në çështjet administrative”.

Neni 10

“Të drejtë për të nisur konfliktin administrativ ka personi fizik si dhe personi juridik, nëse vlerëson se me aktin administrativ përfundimtar në procedurën administrative, i është shkelur ndonjë e drejt apo interes ligjor.

[...]"

Neni 11

"Konflikti administrativ, sipas aktpadisë, zgjidhet nga Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës".

Neni 26

Procedura në bazë të padisë

"Konflikti administrativ fillohet me padi.

[...]"

Neni 27

"1. Padia paraqitet brenda tridhjetë (30) ditësh, që nga data e dorëzimit të aktit administrativ përfundimtar palës".

Neni 30

"1. Në padi duhen të përfshihen: emërtimi i gjykatës të cilës i paraqitet padia, emri, mbiemri dhe vendbanimi, respektivisht selia e paditësit dhe e të paditurit, akti administrativ kundër të cilit është drejtuar padia, arsyet pse ngrihet padia, si dhe në cilin drejtim dhe vëllim propozohet anulimi i aktit administrativ. Bashkë me padinë duhet të bashkangjitet akti që kontestohet në origjinal ose kopje".

Ligji për Procedurën Kontestimore, Ligji nr. 03/L- 006

KREU XXII

MJETET PROVUESE DHE MARRJA E PROVAVE

Neni 322.

[...]"

322.2 Pala që pretendon se i takon një e drejtë ka për detyrë të provojë faktin që është qenësor për krijimin ose realizimin e saj, po që se ligji nuk parasheh diç tjetër.

[...]"

LIGJI MBI MARRËDHËNIET E DETYRIMEVE-Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, nr. 29/78, 39/85, 45/89

II. Vëllimi i kompensimit të dëmit material
Dëmi i thjeshtë dhe përfitimi i munguar

- “(1) I dëmtuari ka të drejtë si për kompensimin e dëmit të thjeshtë ashtu edhe për kompensimin e fitimit të munguar*
- (2) Shuma e dëmit të thjeshtë caktohet sipas çmimeve në kohën e nxjerrjes së vendimit gjyqësor me përjashtim të rastit kur ligji urdhron diçka tjetër.*
- (3) Gjatë vlerësimit të shumës së perfitimit të munguar merret në konsiderim fitimi ka mundur të pritej në mënyrë të bazuar sipas procesit të rregullt të sendeve ose sipas rrethanave të veçanta ndërsa realizimi i të cilave është penguar nga veprimi i dëmtuesit ose nga ometimi.*
- (4) Kur sendi është asgjësuar ose është dëmtuar për shkak të veprës penale të kryer me dashje gjykata mund të caktojë shumën e kompensimit sipas vlerës që ka pasur sendi për të dëmtuarin”.*

Pranueshmëria e kërkesës

31. Gjykata fillimisht shqyrton nëse kërkesa i plotëson kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
32. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:
- “1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
[...]
7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.
33. Gjykata, gjithashtu, i referohet nenit 49 [Afatet] të Ligjit, i cili përcakton:
- “Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtuesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. [...]*”
34. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit, i cili përcakton:
- “Parashtuesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtuesi dëshiron ta kontestoj”.*

35. Sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata gjen se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin e Gjykatës Supreme PML nr. 162/2021, të 8 nëntorit 2021, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të parashikuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu i ka qartësuar të drejtat dhe liritë themelore që ai pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit, si dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.
36. Gjykata gjithashtu i referohet paragrafit 2d) të rregullit 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës, i cili përcakton:
- (2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.*
37. Bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ) por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave si “pretendime qartazi të pabazuara”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kualifikohen si pretendime “të shkallës së katërt”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”; (iii) pretendime “të pambështetura apo të paarsyetuara”; dhe në fund, (iv) pretendime “konfuze dhe të paqarta”. Këtë koncept të papranueshmërisë mbi bazën e një kërkesë të vlerësuar si “qartazi të pabazuar”, dhe specifikat e katër kategorive të lartcekura të pretendimeve të kualifikuara si “qartazi të pabazuara” të zhvilluara përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, Gjykata i ka përvetësuar edhe në praktikën e saj gjyqësore përfshirë por duke mos u kufizuar në rastet KI40/20 me parashtrues *Sadik Gashi*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 20 janarit 2021; KI163/18, me parashtrues *Kujtim Lleshi*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 24 qershorit 2020; KI21/21, me parashtrues, *Asllan Meka*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 28 prillit 2021, KI107/21, me parashtrues *Ramiz Hoti*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 21 tetorit 2021).
38. Në kuptim të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, përkatësisht, në vlerësimin nëse kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata, fillimisht do të rikujtojë esencën e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
39. Gjykata e vëren se thelbi i pretendimeve nga kërkesa e parashtruesit ka të bëjë me procedurën gjyqësore të cilën ai e ka filluar dhe udhëhequr me qëllim të realizimit të të drejtave në kompensimin e fitimit të humbur, të cilat kanë

ardhur për shkak se ministria nuk i kishte lëshuar leje për zhvillimin e trafikut me autobus në relacionin Prizren-Prishtinë dhe anasjelltas, me kohë të nisjes në orën 16:30. Duke e pasur parasysh këtë, Gjykata në vazhdim të aktvendimit do t'i shikojë pretendimet e parashtruesit të kërkesës në kontekstin e procedurës gjyqësore në fjalë e cila ka përfunduar me nxjerrjen e aktgjykimit të plotfuqishëm të Gjykatës Supreme, Rev.nr.162/2021.

Procedura gjyqësore për kompensimin e fitimit të humbur

40. Duke shqyrtuar me vëmendje vetë thelbin e procedurës gjyqësore të iniciuar nga parashtruesi i kërkesës në vitin 2007, Gjykata gjen se gjykatat e rregullta kanë vendosur për kërkesëpadinë, duke sjellë aktgjykime me të cilat kanë refuzuar kërkesëpadinë e tij për kompensimin e fitimit të humbur si të pabazuar.
41. Sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, pikërisht konkluzionet e tilla të gjykatave të rregullta kanë rezultuar me shkelje të të drejtave të tij të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, si dhe me nenin 54 të Kushtetutës.
42. Më konkretisht, Gjykata konstaton se thelbi i shkeljes së nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, është krijuar për shkak se **a) gjykatat e rregullta nuk e kanë analizuar thelbin e kërkesës për kompensim të dëmit, dhe b) gjykatat i kanë zvarritur qëllimisht procedurat gjyqësore.**
 - i) *Sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës se gjykatat e rregullta nuk e kanë analizuar kërkesën për kompensim të dëmit*
43. Duke e shqyrtuar me vëmendje pretendimin e parë të parashtruesit të kërkesës, Gjykata gjen se ai konsideron se shkelja e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së ka ndodhur në të gjitha instancat e gjykatave të rregullta për shkak se ato nuk e kanë analizuar në mënyrë konkrete kërkesëpadinë e tij me të cilën ka kërkuar të realizojë të drejtën e kompensimit.
44. Duke pasur parasysh se parashtruesi i kërkesës konsideron se shkelja e së drejtës për gjykim të drejtë ka ndodhur në të gjitha fazat e procedurës së rregullt gjyqësore, kjo gjykatë ka për detyrë të shqyrtojë këto procedura “në tërësi”, gjë që është në pajtim me praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ) e cila thotë se “*është detyrë e Gjykatës të shqyrtojë procedurën në tërësi, që në rastin konkret përfshin të gjitha vendimet e gjykatave të rregullta në një procedurë*” (shih, ndër të tjera, Aktgjykimin e GJEDNJ-së në rastin *Helmers kundër Suedisë* të 29 tetorit 1991, Seria A nr. 212, faqe 15, paragrafi 31).
45. Pikërisht në lidhje me këtë, Gjykata, duke analizuar procedurën gjyqësore në Gjykatën Themelore, vëren se ajo, para shqyrtimit të thelbit të kërkesëpadisë lidhur me kompensimin e parashtruesit të kërkesës, shqyrtoi çështjen e përmbushjes së kushteve që do t'i mundësonin Gjykatës Themelore të merret

me vërtetimin e të drejtave të parashtruesit të kërkesës lidhur me të drejtën për kompensim.

46. Përkitazi me këtë, Gjykata Themelore konkludoi se kushti që ajo të shqyrtojë kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës nuk është plotësuar *“për faktin se nuk ka bazë juridike për të shqyrtuar thelbin e kërkesëpadisë”*. Një qëndrim të tillë Gjykata Themelore e gjeti në faktin se parashtruesi i kërkesës nuk ka iniciuar brenda afatit konfliktin administrativ në Gjykatën Supreme, në të cilin do të kërkonte vërtetimin e ligjshmërisë së vendimit të Ministrisë. Si rezultat i kësaj, Gjykata Themelore nuk e kishte para vetes as vendimin e Gjykatës Supreme për ligjshmërinë e vendimit të kontestuar të Ministrisë, i cili do të shërbente si bazë juridike mbi të cilën ajo do të përcaktonte të drejtën e paditësit në kompensim. Rrjedhimisht, konstatimi i Gjykatës Themelore në Aktgjykimin e saj ishte se *“ligjshmëria e vendimeve të paditurit nuk është kundërshtuar nga paditësi i cili ka pasur mundësi që me padi të inicon konfliktin administrativ, në afatin ligjor prej 30 ditëve nga momenti kur e ka pranuar memorandumin e dt. 21.12.2004”*.
47. Bazuar në këtë, është evidente se Gjykata Themelore nuk është marrë në kuptimin thelbësor me çështjen e realizimit të së drejtës së parashtruesit në kompensim, dhe atë për faktin se parashtruesi i kërkesës e ka humbur mundësinë ligjore për të marrë një vendim për ligjshmërinë e vendimit të Ministrisë i cili do të paraqiste bazë të mjaftueshme juridike për Gjykatën Themelore për t’u marrë me çështjen e kompensimit.
48. Për më tepër, Gjykata gjithashtu gjen se Gjykata Themelore vlerësoi edhe kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës në lidhje me faktin se një nga zyrtarët e Ministrisë në mënyrë të paligjshme hoqi emrin e kompanisë së tij nga lista e vijave të autobusëve të miratuar nga Ministria. Përkitazi me këtë, konkluzioni i Gjykatës Themelore ishte se në bazë të dispozitës së nenit 322.2 të LPK-së, parashtruesi i kërkesës duhet të dëshmojë ekzistimin e faktit të përgjegjësisë së të paditurës, përkatësisht zyrtarëve të saj për dëmin e shkaktuar, gjë që, sipas mendimit të saj, ai *“nuk ka arritur të vërtetojë me prova ekzistimin e përgjegjësisë së të paditurit për dëmin e shkaktuar”*.
49. Duke shqyrtuar me vëmendje rrjedhën e mëtejme të procedurës gjyqësore në Gjykatën e Apelit, është evidente se Gjykata e Apelit i preku dhe analizoi të gjitha pretendimet ankimore të parashtruesit të kërkesës, duke paraqitur konkluzione si për mungesën e bazës juridike ashtu edhe për çështjen e ekzistimit të përgjegjësisë së të paditurit për dëmshpërblim. Lidhur me këtë, Gjykata e Apelit konkludoi se *“paditësit i mungon baza juridike për të kërkuar shpërblimin e dëmit, pavarësisht nga fakti se dëmi është shkaktuar, por që nuk është kundërshtuar ligjshmëria e vendimeve të të paditurës nga ana e paditësit, i cili është dashur që me padi të inicojë konflikt administrativ në Gjykatën Supreme të Kosovës, si gjykatë e kompetencës lëndore për shqyrtimin e ligjshmërisë së vendimeve të organeve administrative”*.
50. Pikërisht në kontekstin e konkluzionit të Gjykatës së Apelit, kjo Gjykatë dëshiron të shtojë se për të ekzistuar e drejta për shpërblimin e dëmit nuk mjafton që vetëm të vërtetohet fakti i ekzistimit të dëmit material por duhet të

ekzistojë edhe përgjegjësia e subjektit për dëmin e shkaktuar. Sipas mendimit të Gjykatës së Apelit, është evidente se parashtruesi i kërkesës nuk ka arritur të provojë me provat e tij se dëmi i pretenduar është shkaktuar nga veprimet ose mosveprimet e Ministrisë ose zyrtarit të saj.

51. Gjykata më tej i referohet Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, në të cilin ajo, ndër të tjera, vërtetoi gjetjet e gjykatave të instancave më të ulëta në aktgjykimet e tyre, duke theksuar se ato janë të qarta dhe përmbajnë arsyetime të mjaftueshme, si në lidhje me gjendjen faktike ashtu edhe në lidhje me bazën juridike lidhur me realizimin e së drejtës për kompensim.
52. Duke arsyetuar pikërisht çështjen e pamundësisë së realizimit të së drejtës për kompensim, Gjykata vëren se Gjykata Supreme ka prekur dispozitën ligjore të nenit 189 paragrafi 1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (në tekstin e mëtejshëm: LMD), e cila parashikon të drejtën e të dëmtuarit për kompensimin e dëmit të thjeshtë apo të fitimit të munguar. Mirëpo, për të realizuar këtë të drejtë, i dëmtuari, sipas pretendimeve të Gjykatës Supreme, duhet t'i plotësojë kushtet nga paragrafi 3 i nenit 189 të LMD-së. Këto kushte janë: a) që dëmi në formën e fitimit të humbur të jetë evident, b) të ekzistojnë elemente në bazë të të cilave mund të caktohet fitimi i humbur, dhe c) që ky mos të jetë në kundërshtim me dispozitat në fuqi dhe me doket e mira afariste.
53. Andaj, Gjykata Supreme duke i ndërlidhur pretendimet e parashtruesit të kërkesës me dispozitën relevante ligjore të paragrafit 3 të nenit 189 të LMD-së, arriti në përfundim se *“gjykatat e instancave më të ulëta, me të drejtë kanë vërtetuar se nuk ka bazë juridike për shpërblimin e dëmit në emër të fitimit të humbur, dhe se nuk është vërtetuar se me veprimet e të paditurës, është shkaktuar dëmi material për parashtruesin e kërkesës”*.
54. Me një përfundim të tillë pajtohet edhe kjo Gjykatë, për arsye se të gjitha instancat e gjykatave të rregullta kanë konstatuar se, i) parashtruesi i kërkesës nuk e ka iniciuar procedurën administrative në Gjykatën Supreme, ii) nuk e ka pranuar vendimin e gjykatës kompetente për çështjen e ligjshmërisë së vendimit të Ministrisë, dhe se iii) kështu gjykatat e rregullta në kërkesën e parashtruesit për kompensim nuk kanë pasur bazë juridike mbi të cilën do të konstatonin se ekziston një vendim i kundërligjshëm që i ka shkaktuar dëm parashtruesit të kërkesës, duke ia caktuar në këtë mënyrë lartësinë e mundshme të kompensimit.
55. Rrjedhimisht, Gjykata i konsideron pretendimet e parashtruesit të kërkesës *“se gjykatat e rregullta nuk e kanë analizuar kërkesën për dëmshpërblim duke shkelur kështu nenin 31 të Kushtetutës si dhe nenin 6 të KEDNJ-së”* si qartazi të pabazuara.
 - ii) *Lidhur me pretendimin e parashtruesit të kërkesës se gjykatat e rregullta i kanë zvarritur qëllimisht procedurat gjyqësore*
56. Duke e shqyrtuar me vëmendje pretendimin e dytë të parashtruesit të kërkesës në kontekst të shkeljes së nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, të

cilin ai e ndërlidh me faktin se “*gjykatat e rregullta me qëllim kan zhagitur procedurën gjyqësore*”, Gjykata konsideron se këto pretendime shkojnë në favor të arsyeshmërisë së kohëzgjatjes së procedurës gjyqësore të cilën parashtuesi i kërkesës e ka zhvilluar në procedurën e realizimit të së drejtës për kompensim.

57. Në mbështetje të kësaj, Gjykata rikujton se sipas praktikës së GJEDNJ-së, arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procedurës duhet të vlerësohet në kuadër e rrethanave të rastit të veçantë, duke marrë parasysh kriteret e vendosura nga praktika e GJEDNJ-së dhe në veçanti ndërlikueshmërinë e rastit, sjelljen e palëve në procedurë dhe të gjykatës kompetente ose autoriteteve të tjera publike, si dhe rëndësinë të cilën çështja konkrete juridike ka për parashtuesin e kërkesës (shih, GJEDNJ, *Mikulić kundër Kroacisë*, kërkesa numër 53176/99, e 7 shkurtit 2002, Raporti numër 2002-I, paragrafi 38).
58. Megjithatë, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e rastit para gjykatave të rregullta, si në aspektin formal, ashtu edhe në atë material, duke përfshirë edhe hapat proceduralë që kanë qenë të domosdoshëm për t’u ndërmarrë me qëllim të nxjerrjes së një vendimi të drejtë, sjelljen e parashtuesit të kërkesës dhe gjykatave të rregullta, si dhe ndërlikueshmërinë e rastit, Gjykata është e mendimit se procedura gjyqësore sipas kërkesëpadsisë për kompensim, e cila ka zgjatur 13 vjet, brenda të cilës gjykatat e rregullta kanë marrë 2 (dy) aktgjykime në procedurën e parë, si dhe 3 (tri) aktgjykime në procedurën e përsëritur, nuk mund të konsiderohet si *zvarritje e qëllimshme e procedurës gjyqësore*, prandaj konsideron se nuk ka shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së në kontekst të arsyeshmërisë së kohëzgjatjes së procedurës gjyqësore.
59. Prandaj, Gjykata konkludon se pretendimet e parashtuesit të kërkesës për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së duhet të shpallen të papranueshme në tërësi si qartazi të pabazuara sepse këto pretendime kualifikohen si pretendime që hyjnë në kategorinë (iii) pretendime “*të pambështetura apo të paarsyetuara*”. Rrjedhimisht, këto pretendime janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

Pretendimet për shkelje të nenit 49 [E drejta për punë dhe ushtrim të profesionit] të Kushtetutës

60. Sa iu përket pretendimeve për shkeljen e nenit 49 të Kushtetutës, parashtuesi i kërkesës pretendon se i janë shkelur këto të drejta kushtetuese, sepse emri i tij dhe i kompanisë i është larguar nga itinerari i udhëtimeve në mënyrë arbitrare nga ana e zyrtarëve të ministrisë dhe jo në bazë të ligjit. Parashtuesi posaçërisht e thekson faktin “që kompania “Express Tur” është kompania e vetme në pronësi të një anëtarit pakicë në Kosovë”.
61. Megjithatë, duke e analizuar këtë pretendim të parashtuesit të kërkesës në kontekstin e procedurës gjyqësore të zhvilluar nga ai, gjejmë se procedura gjyqësore në fjalë kishte të bënte ekskluzivisht me mundësinë e realizimit të kompensimit në emër të fitimit gjoja të humbur, për të cilin gjykatat e rregullta

edhe kanë vendosur, e jo për çështjen e të drejtës në punë dhe ushtrim të profesionit. Më konkretisht, Gjykata nuk ka gjetur se gjykatat e rregullta në aktgjykimet e veta në çfarëdo mënyre e kanë shqyrtuar çështjen e cila do të ishte në korrelacion të drejtë me këtë nen të Kushtetutës, dhe me këtë, nuk kanë sjellë as aktgjykime me të cilat ato i kanë ndaluar atij të punojë dhe të ushtrojë profesionin.

62. Duke e pasur parasysh këtë, Gjykata këtë pretendim të parashtruesit të kërkesës e cilëson si pretendim (iii) “të pambështetur apo të paarsyetuar”, në përputhje me rregullën 39, paragrafin 2 të Rregullores së punës.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës

63. Gjykata gjithashtu gjen se parashtruesi i kërkesës konsideron se atij i është shkelur edhe neni 54 i Kushtetutës “për shkak se *Gjykata Komunale ka konstatuar se kontesti ndërmjet palëve është konflikt administrativ. Edhe pse ka konstatuar kështu, Gjykata Komunale në Prishtinë nuk ka dërguar shkresat e lëndës gjykatës kompetente për konfliktet administrative, duke shkelur kështu të drejtën time për mbrojtje gjyqësore*”.
64. Në vazhdim, sa i përket këtij pretendimi për shkelje të nenit 54 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës e ndërlidh këtë pretendim me procedurën në Gjykatën Komunale. Më konkretisht, parashtruesi i kërkesës konsideron se “*Gjykata Komunale, në vitin 2010, kur vërtetoi se ajo është kompetente për zgjidhjen e kërkesëpadisë së tij për shkak se bëhet fjalë për konfliktin administrativ, është dashur t'i dërgojë shkresat e lëndës në gjykatën kompetente për konfliktet administrative*”.
65. Duke iu përgjigjur këtij pretendimi të parashtruesit të kërkesës, Gjykata i referohet dispozitave relevante të Ligjit për Procedurën Administrative, të cilat në mënyrë të qartë shpjegojnë procedurën e paraqitjes së kërkesëpadisë në gjykatën kompetente në kompetencën e së cilës zgjidhet konflikti administrativ. Kështu neni 10 i Ligjit për Procedurën Administrative parashikon se konflikti administrativ mund të fillohet nga personi fizik ose juridik me paraqitjen e kërkesëpadisë (neni 26 i Ligjit) në Gjykatën Supreme si gjykatë kompetente për zgjidhjen e konflikteve administrative (neni 11 i Ligjit), ndërsa neni 30 i Ligjit parashikon saktësisht se çfarë duhet të përmbajë një padi administrative, ku, ndër të tjera, në paragrafin e parë thuhet se “[...] në padi duhet të përfshihen: emërtimi i gjykatës të cilës i paraqitet padia...”.
66. Duke pasur parasysh të lartcekurat, Gjykata konkludon se parashtruesit të kërkesës nuk i është shkelur e drejta nga neni 54 i Kushtetutës, meqenëse e drejta për mbrojtje gjyqësore të të drejtave parashikohet me dispozitat relevante të ligjit, të cilën ai mund të ishte përpjekur ta realizonte në një procedurë në të cilën gjykata kompetente do ta zgjidhte çështjen. Vetë fakti se ai nuk e ka ndjekur rrugën e duhur procedurale nuk është bazë e mjaftueshme që kjo Gjykatë të konstatojë shkelje të nenit 54 të Kushtetutës.

67. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se ky pretendim i parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 54 të Kushtetutës duhet të refuzohet si (iii) pretendim “i pambështetur apo i paarsyetuar”, në pajtim me rregullin 39, paragrafin 2 të Rregullores së punës.

Përfundim

Gjykata konkludon,

(i) sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, Gjykata e refuzon këtë pretendim si qartazi të pabazuar në baza kushtetuese, në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës,

(ii) sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 49 dhe 54 të Kushtetutës, Gjykata po ashtu e hedh poshtë si qartazi të pabazuar në baza kushtetuese, në përputhje me rregullin 39. 2 të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 47 dhe 48 të Ligjit dhe me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, më 22 qershor 2022, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. TUA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Bajram Llatifi




Besa Caka-Nimani